



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 27 qershor 2012, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Sasha Gjokiq, Liburn Aliu, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi dhe Flora Brovina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- Administratore e Komisionit; Enis Halimi – Zyrtar i fushës për shëndetësi dhe Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat;**
- 3. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat

Fikrim Damka- Tha se do të shqyrtojmë amendamentet e grupit punues për këtë projektligj. Fjalën ia kaloi Sasha Gjokiqit, si kryesues i grupit punues.

Sasha Gjokiq- E informoi Komisionin se grupi punues ka hartuar amendamentet e nevojshme për këtë projektligj, si vijon:

Amendament 1

Në nenin 5 të Projektligjit, paragrafin 2, pas fjalës „ ndërmjetësimit “shtohet fjalia „ sipas ligjit për ndërmjetësimin dhe “

Amendament 2

Në nenin 5, të Projektligjit, paragrafi 2a, fshihet fjala „ arbitrazhit” dhe zëvendësohet me „ pajtimit dhe ndërmjetësimit”

Amendament 3

Pas nenit 6, të projektligjit, shtohet nen i ri si vijon:

1. Në nenin 18 të ligjit bazik, paragrafin 1 pas fjalisë,, Kontrata e Punës “ shtohet fjalia: „ duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punuar”.

2. Në nenin 18 të ligjit bazik, pas paragrafit 1, shtohet paragraf i ri 1.a. me tekstin si vijon:

1a. Periudha e pezullimit sipas paragrafit 1, nuk prek vjetërsinë në punë dhe efektet e saj.

Amendament 4

Në nenin 7, paragrafin 2, fshihet “7 (shtatë)” dhe zëvendësohet me „ 5 (pesë)ditë pune”

Amendament 5

Në nenin 8, të Projektligjit, paragrafi 4, fshihet fjala „ ka fuqinë e aktit ligjor “ dhe zëvendësohet me „ ka fuqi ligjore “.

Komisioni unanimisht miratoi Projektligjnt për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat me amendamentet e propozuara.

3. Të ndryshme

Fikrim Damka- Kërkoj të dijë deri ku ka arritur grupi punues për monitorimin e Ligjit të punës.

Liburn Aliu- Si kryesues i grupit punues, e informoi Komisionin se grupi punues i ka kryer vizitat e nevojshme dhe tash ka mbetur për t'u hartuar raporti me rekomandime për seancë plenare. Do të ishte mirë që ta organizojmë një takim me përfaqësuesit e MPMS për t'ua prezantuar shqetësimet tona lidhur me këtë ligj.

Fikrim Damka- Tha se MPMS është në proces të plotësimit ndryshimit të këtij ligji dhe ata janë të interesuar që t'i kenë rekomandimet tona rreth këtij ligji.

Salihe Mustafa- Deklaroi se jam për variantin që gjysma e punëtorëve të kenë të drejtë për grevë dhe jo 1/3 e tyre.

Flora Brovina- Është mirë që të ftojme numër sa më të madh të pjesëmarrësve për tryezën që do ta mbajmë për Projektligjin për shëndetësi.

Nazane Breca- Për shkak të rëndësisë së projektligjit, pajtohem që të ketë shumë pjesëmarrës në këtë dëgjim publik.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi ta organizojë një Dëgjim publik për Projektligjin për shëndetësi

Fikrim Damka- Tha se ne duhet të caktojmë ekspertët që do të na ndihmojnë në amendamentimin e Projektligjit për shëndetësi.

Time Kadriaj- Propozoi Luan Jahën, si ekspert.

Nazane Breca- Propozoi Valdet Hashanin, si ekspert.

Liburn Aliu- Propozoi Robert Muharremi dhe Tefik Bekteshin, si ekspertë.

Flora Brovina- Propozoi Bardhyl Hasanpapajn, si i ekspert.

Komisioni me shumicë votash vendosi që të angazhojë ekspertët: Luan Jaha, Valdet Hashani, si ekspertë mjekësor, ndërkaj si ekspert juridik vendosi ta angazhojë Robert Muharremi.

Fikrim Damka- Tha se ka ardhur Projektligji për pensionet. Kërkoj nga ju që, para se ta diskutojmë në Komision, të bisedoni me grupet tuaja parlamentare, në mënyrë që të mos kemi kundërthënie, sikundër kemi pasur me parë.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka